



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEÇ
KËSHILLI

Komisioni I Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkise, Mbiqyrjes Financiare, I Ekonomise Vendore, Turzimit dhe Zhvillimit Rural

Raport vendimmarrije

Nr 11 /Datë 22.04 2025

Lënda: Mendim/vendim i Komisionit për projektvendimin "PËR MIRATIMIN E, LISTËS SË FONDIT KULLOSOR, QË MUND TË JEPEN ME QERA, PËR KULLOTJE E KOSITJE BARI, ME SIPËRFAQE PREJ 1512,75 HA, NË EKONOMITËKULLOSORE;"GOLIK-KALIVAÇ","VËRRI DEBROVË","PRETUSHË-LIN", "GURI TOP-GJEMTH", "DUNICË-LLËNGË" DHE "NIÇË-VALAMARË", DHE KONTRATËS TIP . shoqëruar nga relacioni dhe dokumentet shoqëruese, të mbledhjes së këshillit bashkiak, datë 29.04.2025

Analiza ligjore:

Në mbështetje të; nenit 8, shkronjës "c" të pikës 1.2 të nenit 9, pikës 5 të nenit 27, shkronjës "e" të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, nenit 15 të Ligjit Nr.9693, datë 19.3.2007, "Për fondin kullosor", i ndryshuar, VKM nr.398 datë 13.05.2020 për disa ndryshime në Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr.433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike,sipas listës së inventarit,dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave e bashkive", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.632, datë 11.06.2009 "Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje" si dhe të Udhëzimit Nr. 2, datë 20.07.2016 të Ministrit të Mjedisit "Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari"

Situata aktuale e funksionit:

Sipërfaqet kullosore sipas ekonomive kullosore që janë në pronësi të bashkisë do të jepen me qera për kullotje të blegtorisë,mbasi lista të miratohet në Këshillin Bashkiak.

Dhenia e kullotave me qera ose përdorim për kullotje e kositje bari do t'iu nënshtrohen rregulave dhe parimeve të mëposhtme:

1. Kullotat dhe livadhet në pronësi të bashkisë do të jepen në përdorim ose qera, për kullotjen e bagëtive ose për kositje të barit, përkundërt tarifave të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Ato do të jepen personave fizikë e juridikë për një periudhë kohe 1 deri në 3 vjet.

3. Dhënia në përdorim për kullotje bëhet në përputhje me aftësitë mbajtëse kullimore, të përcaktuara në planin e mbarrështimit për çdo ngastër ose nën-ngastër.

4. Dhënia për kullotje e kullotave dhe e livadheve, do të bëhet në bazë të një kontrate, që lidhet ndërmjet strukturës përgjegjëse përkatëse për pyjet dhe kullotat në bashki dhe kërkuesit.

5. Personi fizik ose juridik, që ka marrë kullotë apo livadh për kullotje ose kositje, nuk mund ta japë atë apo pjesë të saj tek të tretë me nënkontratë.

Dhënia e ketyre sipërfaqeve kullimore në përdorim nuk çënon kullotat për tufëzat e vogëla apo gjedhet për nevoja familjare të banuesve në fshat, pasi këto sipërfaqe ndodhen larg fshatrave të banuar. (Detajet në relacion)

Situata financiare:

Detaje teknike në relacion

Drejtoria/Spektori përgjegjës: *AGJENCIA E MBROJTJES SË TERRITORIT*

Inspektoriati i Shërbimit Kontrollit dhe Mbrojtjes së Pyjeve dhe Kullotave

(Spektori i Kullotave)

Monitorimi dhe raportimi:

AGJENCIA E MBROJTJES SË TERRITORIT

Inspektoriati i Shërbimit Kontrollit dhe Mbrojtjes së Pyjeve dhe Kullotave

(Spektori i Kullotave), Keshilli bashkiak Pogradec

Impakti social/grupet që preken:

Fermeret e bashkise Pogradec

A është objekt i konsultimit publik?

Po

Komisioni I Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkise, Mbrojtjes Financiare, I Ekonomise Vendore, Turzimit dhe Zhvillimit Rural I mbledhur më datë 22.04. 2025, shqyrtoi projekt-vendimin për "PËR MIRATIMIN E, LISTËS SË FONDIT KULLOSOR, QË MUND TË JEPEN ME QERA, PËR KULLOTJE E KOSITJE BARI, ME SIPËRFAQE PREJ 1512,75 HA, NË EKONOMITË KULLOSORE; "GOLIK-KALIVAÇ", "VËRRI DEBROVË", "PRETUSHË-LIN", "GURI TOP-GJEMTH", "DUNICË-LLËNGË" DHE "NIÇË-VALAMARË", DHE KONTRATËS TIP shoqëruar nga relacioni dhe dokumentet shoqëruese të tij.

Pas shqyrtimit të projektvendimit dhe materialeve shoqëruese, komisioni me shumicë votash, vendosi:

T'i propozojë Keshillit bashkiak:

- a- (Miratimin e projektaktit.
 - b- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim.
 - c- Refuzimin e miratimit të projektaktit.
 - d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si më poshtë:)
-
-
-

Bashkëlidhur argumentet e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së komisionit.

Gelmuk Haxhillari Kryetar i komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Mumaza Shuli Sekretar i komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Datë: 22.04. 2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEÇ
KËSHILLI

Komisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, Marrëdhëniet me jashtë dhe Integrimin Europian

Raport vendimarrjeje

Nr 5 /Datë 22.04 2025

Lënda: Mendim/vendim i Komisionit për projektvendimin “PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI 6% E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE, PËR MUAJIN MARS 2025”, shoqëruar nga relacioni dhe dokumentet shoqëruese, të mbledhjes së këshillit bashkiak, datë 29.04.2025

Analiza ligjore:

Ky projekt -vendim është hartuar në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1, shkronja (a) dhe (b), nenit 55, pikat 2 dhe 6 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; nenit 21 të ligjit nr.57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, vendimit nr.597, datë 4.09.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Pogradec Nr.3 datë 27.01.2025, “Për miratimin e kriterëve të familjeve në nevojë që do të trajtohen me fondin deri në 6% nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”

Situata aktuale e funksionit:

Nga dokumentacioni i paraqitur, si dhe nga verifikimet e kryera nga administratorët shoqërorë të njësive përkatse, Drejtoria e Shërbimit Social dhe Kryetari i Bashkisë, konkludojnë dhe propozojmë:

Të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi 6% i fondit të kushtëzuar të ndihmës ekonomike për muajin **MARS 2025** gjithsej **174** familje me fond **720227** lek. Te dhenat e detajuara janë paraqitur në relacionin shoqërues të projekt-vendimit përkatës.

Situata financiare:

Për muajin MARS 2025 janë përfitues gjithsej 174 familje me fond 720227 lekë
Drejtoria/Spektori përgjegjës:

Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar dhe të gjitha Njësitë Administrative të Bashkisë Pogradec

Monitorimi dhe raportimi:

Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar dhe të gjitha Njësitë Administrative të Bashkisë Pogradec

Keshilli bashkiak Pogradec

Impakti social/grupet qe preken:

Familjet perfituese te ndihmes ekonomike te Bashkise Pogradec

A është objekt i konsultimit publik?

Jo

Komisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, Marrëdhëniet me jashtë dhe Integrimin European, I mbledhur më datë 22.04 2025, shqyrtoi projekt-vendimin për "PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI 6% E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE, PËR MUAJIN MARS 2025" shoqëruar nga relacioni dhe dokumentet shoqëruese të tij.

Pas shqyrtimit të projektvendimit dhe materialeve shoqëruese, komisioni me shumicë votash, vendosi:

T'i propozojë Keshillit bashkiak:

- a- *(Miratimin e projektaktit.*
- b- *Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim.*
- c- *Refuzimin e miratimit të projektaktit.*
- d- *Miratimin e projektaktit me ndryshimet si më poshtë:)*

Bashkëlidhur argumentet e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së komisionit.

Almoza Shuli  **Kryetar i komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Arben Mali **Sekretar i komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Datë: _____ 2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEÇ
KËSHILLI

Komisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, Marrëdhëniet me jashtë dhe Integrimin Europian

Raport vendimmarrije

Nr 10 /Datë 22.04.2025

Lënda: Mendim/vendim i Komisionit për projektvendimin për “MIRATIMIN E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR RININË NË BASHKINË POGRADEÇ 2025-2028”. shoqëruar nga relacioni dhe dokumentet shoqëruese, të mbledhjes së këshillit bashkiak, datë 29.04.2025

Analiza ligjore:

Ky projekt -vendim është hartuar në mbështetje të pikës 2 të nenit 8, pikës 1.2 gërma “a”; të nenit 9, nenit 54, gërma “dh”, të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, si dhe bazuar në Ligjin 75/2019 “Për Rininë”, Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029.

Situata aktuale e funksionit:

Bashkia Pogradec, në bashkëpunim me Qendrën për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri, me mbështetjen e Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe Ministrisë të Shtetit për Fëmijët, ka realizuar hartimin e Planit Lokal të Veprimit për Rininë 2025-2028. Plani Lokal i Veprimit për Rininë, ka dale si rezultat i konsulencës dhe takimeve me të rinjtë, nxënësit e Shkollave të Mesme, grupimet rinore dhe organizatat që operojnë në mënyrë aktive në Bashkinë Pogradec. Qëllimi i planit lidhet me avancimin e të rinjve duke nxitur ndërmarrjen e veprimeve aktive, në fushën sociale, ekonomike, politike dhe vendimmarre. Hartimi i këtij Plani ka identifikuar si prioritet punësimin dhe sipërmarrjen rinore, pjesëmarrjen dhe përfaqësimin rinor në politikë dhe vendimmarje, arsimit cilësor dhe gjithëpërfshirës, përfshirjen e të rinjve në çështjet sociale, shëndetësore dhe shërbimet publike, mbështetjen e organizatave dhe nismave rinore në Bashkinë Pogradec. Miratimi i këtij plani synon identifikimin e problemeve, nevojave dhe prioritetëve të të rinjve të Pogradecit dhe ofrimi i zgjidhjeve të mundshme, nëpërmjet ofrimit të menyrave, mekanizmave dhe mjeteve të caktuara për të adresuar dhe zgjidhur problematikat e evidentuara.

Situata financiare:

Referuar dokumentit të Planit

Drejtoria/Spektori përgjegjës:

Drejtoria e Turizmit, Trashëgimise Kulturore dhe Rinisë.

Monitorimi dhe raportimi:

Drejtoria e Turizmit, Trashëgimise Kulturore dhe Rinisë.

Keshilli bashkiak Pogradec

Impakti social/grupet qe preken:

Te rinjte, komunitetit, grupe interesi te Bashkise Pogradec

A është objekt i konsultimit publik?

Po, realizuar konsultimi publik.

Komisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjimore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, Marrëdhëniet me jashtë dhe Integrimin European, I mbledhur më datë _____ 2025, shqyrtoi projekt-vendimin për "MIRATIMIN E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR RININË NË BASHKINË POGRADEK 2025-2028". shoqëruar nga relacioni dhe dokumentet shoqëruese të tij.

Pas shqyrtimit të projektvendimit dhe materialeve shoqëruese, komisioni me shumicë votash, vendosi:

T'i propozojë Keshillit bashkiak:

- a- *(Miratimin e projektaktit.*
 - b- *Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim.*
 - c- *Refuzimin e miratimit të projektaktit.*
 - d- *Miratimin e projektaktit me ndryshimet si më poshtë:)*
- _____
- _____
- _____

Bashkëlidhur argumentet e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së komisionit.

Memora Shuli  **Kryetar i komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Anber Hale  **Sekretar i komisionit**
(emri, mbiemri, firma)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEĆ
KËSHILLI

Komisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, Marrëdhëniet me jashtë dhe Integrimin Evropian

Raport vendimmarrije

Nr 6 /Datë 22.04.2025

Lënda: Mendim/vendim i Komisionit për projektvendimin për "MIRATIMIN E IMPLEMENTIMIT NË RAST APROVIMI TË PROJEKTIT STRATEGJIK ME TITULL "CIRCLE" NË KUADËR TË INSTRUMENTIT TË PARA ANTARËSIMIT, IPA III, PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR GREQI-SHQIPËRI 2021-2027" shoqëruar nga relacioni dhe dokumentet shoqëruese, të mbledhjes së këshillit bashkiak, datë 29.04.2025

Analiza ligjore:

Ky projekt -vendim është hartuar në mbështetje të nenit 113, pika 2, të ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998, "*Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*", të ndryshuar, të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 28, pika 1, nenit 54, shkronja "k", nenit 55, pikat 2 dhe 6 të Ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar, ", nenit 32, të Ligjit nr. 68/2017, "*Për financat e vetëqeverisjes vendore*", i ndryshuar, VKM nr.450 datë 26.07.2018 "*Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të integritit evropian, ndërmjet qeverisjes qendrore dhe njërive të vetëqeverisjes vendore*" pika 1 dhe 2 gërma (b) dhe (d) Koordinimi i programeve të asistencës së Bashkimit Evropian në nivel vendor dhe projekteve ku përfiton Bashkia, në lidhje me aplikimin në projektin strategjik me titull "**CIRCLE**", në kuadër të Programit Ndërkufitar Greqi-Republika e Shqipërisë nën Instrumentin e Asistencës së Paraantarësimit (IPA III) 2021-2027

Situata aktuale e funksionit:

Bashkia Pogradec paraqet për miratim paraprak në rast fitimi të projektit strategjik me titull "**CIRCLE**"

Ky projekt është në kuadër të **granteve të thirrjes së parë për propozime të Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar 2021-2027 Greqi -Republika e Shqipërisë**. Ky propozim vjen duke synuar:

- Mbështetjen dhe drejtimin e strukturave administrative të Bashkisë për përgatitjen e projekteve në kuadër të programeve të asistencës së Bashkimit Evropian si dhe informimi i qartë për Thirrjet për Aplikime të shpallura në kuadër të Programeve të Bashkëpunimit Ndërkufitar dhe Territorial të Bashkimit Evropian.

- Bashkërendimi dhe koordinimi me strukturat e Bashkisë dhe Këshillin Bashkiak për përfshirjen e të gjitha projekteve të financuara nga donator në buxhetin vjetor si dhe në Programin Buxhetor Afatmesëm si dhe parashikimin e detyrueshëm të kostos lokale, bashkëfinancimit nëse ka dhe TVSH.

Thirrja në të cilën bazohet shkrimi i këtij projekti lidhet me ekonominë qarkulluese. Në nivel ministror janë targetuar dy bashki në Republikën e Shqipërisë për të qënë pjesë e aplikimit në këtë thirrje. Pas konsultimit me strukturat drejtuese në bashki, bazuar në nevojat dhe prioritetet e bashkisë është menduar që fokusi i projektit të jetë menaxhimi efikas i mbetjeve; ndarja dhe riciklimi duke qënë në këtë mënyrë koherent me fushën që mbulon kjo thirrje.

Koncepti i “Parkut të Ekonomisë Qarkulluese” - është një koncept që promovon parimet e një ekonomie qarkulluese brenda një zone specifike gjeografike. Ai synon zhvillimin dhe zbatimin e zgjidhjeve për nxitjen e ekonomisë qarkulluese në zonën ndërkufitare. Ai është projektuar për të krijuar një sistem të mbyllur ku burimet maksimizohen, mbetjet minimizohen dhe ndikimi i përgjithshëm mjedisor zvogëlohet. (detajet në relacionin bashkelidhur projekt vendimit)

Partner në këtë projekt janë:

1. WASTE MANAGEMENT OF WESTERN MACEDONIA SA lider projekti. Greqi
2. HELLENIC RECYCLING AGENCY partner Greqi
3. Bashkia Pogradec partner Shqipëri
4. Bashkia Fier partner Shqiperi.

Situata financiare:

Vlera totale e projektit për të dyja palët shqiptare dhe greke është: 1.800.000 euro

Buxheti për Bashkinë Pogradec është 394.616 euro nga të cilat: 315.692,20 euro Kontribut i BE dhe 78.692,80 euro bashkefinancim i Bashkisë Pogradec.

Bazuar në buxhet, Bashkia Pogradec ka detyrimin e kostos së bashkëfinancimit të projektit dhe TVSH-së.

Drejtorja/Spektori përgjegjës:

Njesia e integritetit europian, Kryetari I Bashkisë

Monitorimi dhe raportimi:

Njesia e integritetit europian, Kryetari I Bashkisë

Keshilli bashkiak Pogradec

Impakti social/grupet që preken:

Banoret e Bashkisë Pogradec

A është objekt i konsultimit publik?

Jo

Komisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, Marrëdhëniet me jashtë dhe Integrimin Europian, I mbledhur më datë 22.04. 2025, shqyrtoi projekt-vendimin për "MIRATIMIN E IMPLEMENTIMIT NË RAST APROVIMI TË PROJEKTIT STRATEGJIK ME TITULL "CIRCLE" NË KUADËR TË INSTRUMENTIT TË PARA ANTARËSIMIT, IPA III, PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR GREQI-SHQIPËRI 2021-2027" shoqëruar nga relacioni dhe dokumentet shoqëruese të tij.

Pas shqyrtimit të projektvendimit dhe materialeve shoqëruese, komisioni me shumicë votash, vendosi:

T'i propozojë Këshillit bashkiak:

- a- *(Miratimin e projektaktit.*
 - b- *Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim.*
 - c- *Refuzimin e miratimit të projektaktit.*
 - d- *Miratimin e projektaktit me ndryshimet si më poshtë:)*
- _____
- _____
- _____

Bashkëlidhur argumentet e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së komisionit.

Memoza Shuli  **Kryetar i komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Arben Male **Sekretar i komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Datë: 22.04. 2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEÇ
KËSHILLI

Komisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, Marrëdhëniet me jashtë dhe Integrimin Evropian

Raport vendimmarrieje

Nr 7 /Datë 22.04 2025

Lënda: Mendim/vendim i Komisionit për projektvendimin për "MIRATIM TË IMPLEMENTIMIT NË RAST APROVIMI TË PROJEKTIT ME TITULL " SISTEM INFORMATIV PARALAJMËRUES PËR MBIKËQYRJEN HIDROMETEOROLOGJIKE TOKË-UJË." NË KUADËR TË PROGRAMIT NDËRKUFITAR, INTERREG (VI-A) IPA CBC "GREQI-SHQIPËRI 2021-2027" shoqëruar nga relacioni dhe dokumentet shoqëruese, të mbledhjes së këshillit bashkiak, datë 29.04.2025

Analiza ligjore:

Ky projekt -vendim është hartuar në mbështetje të nenit 113, pika 2, të ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, pika 2, nenit 9, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 28, pika 1, nenit 54, shkronja "k", nenit 55, pikat 2 dhe 6 të Ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ", të Ligjit nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, VKM nr.450 datë 26.07.2018 "Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të integritimit evropian, ndërmjet qeverisjes qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore" pika 1 dhe 2 gërma (b) dhe (d) Koordinimi i programeve të asistencës së Bashkimit Evropian në nivel vendor dhe projekteve ku përfiton Bashkia, në lidhje me aplikimin në projektin me titull "SISTEM INFORMATIV PARALAJMËRUES PËR MBIKËQYRJEN HIDRO-METEOROLOGJIKE-TOKË-UJË", në kuadër të Programit Ndërkufitar Greqi-Republika e Shqipërisë nën Instrumentin e Asistencës së Paraantaresimit INTERREG (VI-A) IPA CBC "GREQI-SHQIPËRI 2021-2027"

Situata aktuale e funksionit:

Bashkia Pogradec paraqet për miratim paraprak në rast fitimi projektin "SISTEM INFORMATIV PARALAJMËRUES PËR MBIKËQYRJEN HIDRO METEOROLOGJIKE TOKË -UJË"

Ky projekt është në kuadër të granteve të thirrjes së parë për propozime të Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Interreg (VI-A) IPA CBC "Greqi-Shqipëri 2021-2027"

Thirrja në të cilën bazohet shkrimi i këtij projekti lidhet me marrjen e masave ndaj ndryshimeve klimatike dhe parandalimi dhe menaxhimi i rreziqeve të lidhura me klimën, përmbytjet dhe rrëshqitjet e dheut ,mbrojtjen civile dhe sistemet e menaxhimit të fatkeqësive. Në këtë kontekst

projekti financon blerjen e nje paisjeje te paisur me një sistemi të integruar informacioni, per monitorimin , mbikëqyrjen hidro-meteorologjike të tokës dhe parashikimin afatshkurtër të rreziqeve mjedisore. Nëpërmjet vendosjes së një sistemi iSAFE, i cili është i pajisur me sensorë në distancë do mund të realizohen matje brenda një rajoni prej disa dhjetëra kilometrash ku do mund të monitorohen:

- stuhitë, duke përfshirë shiun, breshrin dhe borën
- parashikim për përmblytjet e menjëhershme dhe rrëshqitjet e tokës
- sistemi i paralajmërimit të hershëm për autoritetet e mbrojtjes civile

Kështu, qëllimi kryesor i projektit me zhvillimin dhe vendosjen e një rrjeti të tillë në rajonet e aplikimit të projektit, është përcaktimi i bashkëpunimit ndërkufitar dhe shkëmbimi i njohurive për të mbështetur sistemet e paralajmërimit të hershëm dhe menaxhimin e rrezikut për të ofruar të gjitha sa më sipër.

Partner në këtë projekt janë:

1. **Bashkia Kozan** lider projekti. Greqi
2. **Bashkia e Korfuzit** partner Greqi
3. **Observatorit Kombëtar i Kërkimeve të Athinës** partner Greqi
4. **Bashkia Gjirokastrë** partner Shqipëri.
5. **Bashkia Pogradec** partner Shqipëri.

Situata financiare:

Vlera totale e projektit për të dyja palët shqiptare dhe greke është: 1.084.415 euro.

Buxheti për Bashkinë Pogradec është 149,940 euro

Bazuar në këtë buxhet, Bashkia Pogradec ka detyrimin e kostos së bashkëfinancimit të projektit në vlerën 29.988 euro dhe TVSH-së .

Drejtoria/Sektori përgjegjës:

Njesia e integritetit europian, Kryetari I Bashkise

Monitorimi dhe raportimi:

Njesia e integritetit europian, Kryetari I Bashkise

Keshilli bashkiak Pogradec

Impakti social/grupet qe preken:

Banoret e Bashkise Pogradec

A është objekt i konsultimit publik?

Jo


Komisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjimore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, Marrëdhëniet me jashtë dhe Integrimin European, I mbledhur më datë _____ 2025, shqyrtoi projekt-vendimin për "MIRATIM TË IMPLEMENTIMIT NË RAST APROVIMI TË PROJEKTIT ME TITULL "SISTEM INFORMATIV PARALAJMËRUES PËR MBIKËQYRJEN HIDROMETEOROLOGJIKE TOKË-UJË." NË KUADËR TË PROGRAMIT NDËRKUFITAR, INTERREG (VI-A) IPA CBC "GREQI-SHQIPËRI 2021-2027" shoqëruar nga relacioni dhe dokumentet shoqëruese të tij.

Pas shqyrtimit të projektvendimit dhe materialeve shoqëruese, komisioni me shumicë votash, vendosi:

T'i propozojë Këshillit bashkiak:

- a- *(Miratimin e projektaktit.*
- b- *Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim.*
- c- *Refuzimin e miratimit të projektaktit.*
- d- *Miratimin e projektaktit me ndryshimet si më poshtë:)*

Bashkëlidhur argumentet e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së komisionit.

Mimoza Shuli  **Kryetar i komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Arben Male **Sekretar i komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Datë: 22.04.2025 2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEÇ
KËSHILLI

Komisioni I Shendetesise, Veterinarise, Mjedisit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit, I Bujqesise, Pyjeve, Menaxhimit te ujrave, Mbrojtjes se Mjedisit dhe Biodiversitetit,

Raport vendimarrjeje

Nr 8 /Datë 22.04 2025

Lënda: Mendim/vendim i Komisionit për projektvendimin “PER MIRATIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT TË UJITJES SË TOKAVE BUJQËSORE” shoqëruar nga relacioni dhe dokumentet shoqëruese, të mbledhjes së këshillit bashkiak, datë 29.04.2025

Analiza ligjore:

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, neni 9, pika 1.1, neni 23, pika 14, neni 27, pika 1, neni 54 dhe neni 55 të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 15, neni 17 dhe neni 18 dhe kreu IV të ligjit nr. 24/2017 “Për administrimin e ujitjes dhe kullimit”, VKM-në nr. 1108, datë 30.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit”

Situata aktuale e funksionit:

Në zbatim të dispozitave ligjore dhe konkretisht nenit 15, të ligjit nr. 24/2017, “Për administrimin e ujitjes dhe kullimit”, bashkia është përgjegjëse për shfrytëzimin dhe administrimin e infrastrukturës ujëtare dhe të kullimit në tokat bujqësore, nëpërmjet ushtrimit të këtij funksioni dhe shërbimi vetë, me strukturat e saj ose nëpërmjet organizatave të ujitjes të cilat funksionojnë me anëtarësinë e vetë fermerëve në formën e organizimit juridik si OJF (neni 20 e në vijim i ligjit të mësipërm). Momentalisht, shërbimi është kryer nga organizatat e fermerëve në zonat e shërbimit, duke menaxhuar sasinë e ujit në rezervuarë dhe duke aplikuar vetëm një tarifë për sasinë e ujit të përdorur. Situata në këtë sektor realisht ka erdhur duke u përkeqësuar dhe ky shqetësim është shprehur vazhdimisht nga fermerët dhe momentalisht kërkesat dhe ankesat e fermerëve paraqesin një situatë shumë kritike pasi këto organizata nuk po mundën të menaxhojnë shërbimin e furnizimet me ujë për vaditje. Në këtë situatë, duke konsideruar edhe faktin se pavarësisht se organizatave ju është lënë një kohë e konsiderueshme për tu formalizuar dhe për të vepruar sipas parashikimeve ligjore (regjistrimi në gjykatë, miratimi i statuteve dhe akteve të themelimit, funksionimi i bordeve dhe miratimi i tarifave, auditim të shpenzimeve nga Bashkia etj, të gjithë dispozitat të përcaktuara nga ligji i mësipërm nenet 21, 26, 27, 28-37, 38, 42, 43, 46), ato sot funksionojnë përsëri të paformalizuara dhe është e pamundur kontrolli i kryerjes së shërbimit si dhe duke konsideruar faktin se jemi në një situatë emergjente përpara sezonit të

vaditjes massive të bimëve, kërkohet që Bashkia të marrë funksionin e plotë të mirëmbajtjes dhe shfrytëzimit të sistemeve të vaditjes dhe kullimit për ta kthyer atë ne standartet ligjore dhe për të shmangur mungesën e ujit në tokat bujqësore të fermerëve.

Ky fakt është konsultuar me fermerët, të cilët e kanë kërkuar vetë realizimin e shërbimit dhe njëkohësisht me kryeleqtë e fshatrave të cilat kanë në funksion sistem vaditës. (Detajet ne relacion)

Situata financiare:

Tarifim për ujitjen për fermerët në masën 300 lekë/1000 m2 me rrjedhje të lirë dhe 200 lekë /1000 m2 me ngritje mekanike. (tarifë kjo e cila ngelet e pa ndryshuar nga vitet e mëparshme).

Drejtoria/Sektori përgjegjës: *NDËRMARRJA E MIRËMBAJTJES SË INFRASTRUKTURAVE DHE PUNËVE PUBLIKE, SEKTORI UJITJE KULLIM*

Monitorimi dhe raportimi:

NDËRMARRJA E MIRËMBAJTJES SË INFRASTRUKTURAVE DHE PUNËVE PUBLIKE, SEKTORI UJITJE KULLIM, Keshilli bashkiak Pogradec

Impakti social/grupet qe preken:

Fermeret e bashkise Pogradec

A është objekt i konsultimit publik?

Jo

Komisioni I Shendetesise, Veterinarise, Mjedisit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit, I Bujqesise, Pyjeve, Menaxhimit te ujrave, Mbrojtjes se Mjedisit dhe Biodiversitetit,, I mbledhur më datë _____ 2025, shqyrtoi projekt-vendimin per “PER MIRATIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT TË UJITJES SË TOKAVE BUJQËSORE” shoqëruar nga relacioni dhe dokumentet shoqëruese të tij.

Pas shqyrtimit të projektvendimit dhe materialeve shoqëruese, komisioni me shumicë votash, vendosi:

T’i propozojë Keshillit bashkiak:

- a- *(Miratimin e projektaktit.*
- b- *Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim.*
- c- *Refuzimin e miratimit te projektaktit.*
- d- *Miratimin e projektaktit me ndryshimet si më poshtë:)*

Bashkëlidhur argumentet e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së komisionit.

Silvana Bozdo Kryetar i komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Amila Gjashë Sekretar i komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Datë: 22.04. 2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEÇ
KËSHILLI

Komisioni i Shërbimeve Publike, Transportit, Lëvizshmërisë Mjedisore, Parqeve, Rekreacionit, Parkingjeve, Zhvillimit Hapësinor, Infrastrukturës dhe Strehimit

Raport vendimmarrjeje

Nr 9 /Datë 22.04 2025

Lënda: Mendim/vendim i Komisionit për projektvendimin PER “PËR MIRATIMIN E BONUSIT TË QIRASË PËR Z. AGRON ÇELA NË BASHKINË POGRADEÇ” shoqëruar nga relacioni dhe dokumentet shoqëruese, të mbledhjes së këshillit bashkiak, datë 29.04.2025

Analiza ligjore:

Projekt vendimi i është bazuar nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nën-pika 1.1, shkronja “b”, nenit 24 pika 1, nenit 29, pika 1, nenit 54 dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 3, pika 3, nenit 15, pika 5, nenit 33, pika 1, neni 34 pika 3, gërma “g”, të Ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, të ndryshuar, Vendimit nr. 301, datë 15.04.2020, të Këshillit të Ministrave “Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standardet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët”, Vendimit nr. 384, datë 12.6.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, si dhe bazuar në procesverbalin e komisionit të strehimit të Bashkisë Pogradec.

Situata aktuale e funksionit:

Në vijim të Aplikimit në shërbimin elektronik e-albania konkretisht rubrika “Kërkesë për të Përfutur nga Programet e Strehimit Social” së Z. Agron Çela me nr. aplikimi BS060220250002, në datë 06.02.2025, u përgatit dokumentacioni i duhur për të përfutur “Subvencionimi Qerasë” pasi u evidentua gjendja e banimit, gjendja sociale dhe ekonomike. Aplikuesi dhe bashkëshortja trajtohen me ndihmë ekonomike dhe janë familje e komunitetit egjiptian. Në bazë të kushteve të vështira ekonomike, sociale dhe jetesës, zyra e strehimit kërkon shtyrjen e afatit të subvencionimit të bonusit të qerasë edhe për 12 muaj, pasi qytetarit në fjalë akoma nuk i është gjetur një strehim përfundimtar. Bashkangjitur relacionit lista me dokumentat.

Situata financiare:

Efektet financiare të pikës 1, të këtij vendimi në shumën 96,000 (Nëntëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, do të mbulohen nga Fondi Rezervë i Bashkisë Pogradec, detajuar sipas tabelës në Relacionin e këtij projekt vendimi.

Drejtoria/Sektori përgjegjës: Drejtoria e Emergjencave, Strehimit dhe Administrimit i Tokës Bujqësore në Njësitë Administrative dhe Shërbimeve si dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Menaxhimit Financiar, pranë Bashkisë Pogradec

Monitorimi dhe raportimi:

Drejtorja e Emergjencave, Strehimit dhe Administrimit i Tokës Bujqësore në Njësitë Administrative dhe Shërbimeve si dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Menaxhimit Financiar, pranë Bashkisë Pogradec, Keshilli bashkiak Pogradec

Impakti social/grupet që preken:

Z. Agron Cela

A është objekt i konsultimit publik?

Jo

Komisioni I perhershëm i Shërbimeve Publike, Transportit, Lëvizshmërisë Mjedisore, Parqeve, Rekreacionit, Parkingjeve, Zhvillimit Hapësinor, Infrastrukturës dhe Strehimiti, mbledhur më datë 22.04. 2025, shqyrtoi projekt-vendimin për “PËR MIRATIMIN E BONUSIT TË QIRASË PËR Z. AGRON ÇELA NË BASHKINË POGRADEK” shoqëruar nga relacioni dhe dokumentet shoqëruese të tij.

Pas shqyrtimit të projektvendimit dhe materialeve shoqëruese, komisioni me shumicë votash, vendosi:

T’i propozojë Keshillit bashkiak:

- a- (Miratimin e projektaktit.
- b- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim.
- c- Refuzimin e miratimit të projektaktit.
- d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si më poshtë:)

Bashkëlidhur argumentet e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së komisionit.

Ahmed Guxholli
(emri, mbiemri, firma)

Kryetar i komisionit

Vjellca Pellaha
(emri, mbiemri, firma)

Sekretar i komisionit

Datë: 22.04. 2025